



INNVEST
INNOVATION INVESTMENT FUND

Nr. 247 Prot.

Tiranë më 26. 03. 2021

Nr. 30 Prot.

Tiranë më 26. 03. 2021

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet:

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

dhe

INNOVATION INVESTMENT FUND

Me qëllim zhvillimin e politikave për promovimin e të drejtave të pronësisë industriale nëpërmjet:

- Rritjes së ndërgjegjësimit të biznesit, për të drejtat që ata gëzojnë në lidhje me markat tregtare dhe të shërbimit, disenjot industriale apo treguesit gjeografikë të regjistruar.

Si dhe:

- Dëshirën e mirë për krijimin e kushteve të përshtatshme në lidhje me njohjen e biznesit për rëndësinë e regjistrimit të objekteve të pronësisë industriale:

Duke parë nevojën për bashkëpunimin dypalësh, shkëmbimin e informacionit dhe mirëkuptimin dypalësh mes dy institucioneve palë në këtë marrëveshje, në arritjen e objektivit të mësipërm:

lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet:

Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale (në vijim DPPI), me seli në Tiranë, Rr. Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve, përfaqësuar nga Drejtori Znj. Ledina Beqiraj dhe Innovation Investment Fund (në vijim INNVEST), me seli në Tiranë, Rr. Pjetër Bogdani nr. 10 Hy.5, Ap. 28, 1019, përfaqësuar nga Drejtori Znj. Fabiola Duro.

Të cilat, këtu e më poshtë do të njihen si "palët".

DUKE QENË SE:

DPPI është institucioni i vetëm përgjegjës për njohjen, administrimin, regjistrimin dhe promovimin e të drejtave të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë, i krijuar me ligjin nr. 9947 datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", nëpërmjet regjistrimit të patentave të shpikjeve, modeleve të përdorimit, disenjove industriale, markave tregtare dhe të shërbimit, treguesit gjeografikë dhe topografisë së qarqeve të integruara.

DPPI është institucioni që krijon, ruan dhe administron bazën e të dhënave për këto objekte të pronësisë industriale si dhe institucioni përgjegjës për zhvillimin e politikave për promovimin e këtyre të drejtave: Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ka si mision dhe administrimin e regjistrave të objekteve të pronësisë industriale,

dhe

INVEST përmban brenda misionit të tij krijimin e ndikimit konkret në ekonominë e Ballkanit Perëndimor duke siguruar mundësi për rritje, duke mbështetur dhe inkurajuar sipërmarrësit e rinj dhe njëkohësisht duke zvogëluar boshllëkun midis ideve të reja të biznesit dhe mundësive të investimeve.

INVEST bashkon sipërmarrësit kryesorë, startup-e, SME-te, investitorë, investitorët kryesorë, politikë bërësit dhe bashkon një gamë të madhe idesh nga i gjithë spektri inovativ për të adresuar sfidat ekonomike në rang kombëtar dhe rajonal.

Qëllimi i INVEST është të stimulojë inovacionin nëpër sektorë si një shtytje e rëndësishme për ndryshim pozitiv.

Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj marrëveshjeje, është bashkëpunimi mes palëve për:

- a) Rritjen e ndërgjegjësimit të biznesit, për të drejtat që ata gëzojnë në lidhje me markat tregtare dhe të shërbimit, disenjot industriale apo treguesit gjeografikë të regjistruar;
- b) Përgatitjen e materialeve promovuese, fletë-palosjeve, broshurave, të cilat do të vendosën në stenda pranë mjediseve të INVEST.

Neni 2

Qëllimi

Me qëllim realizimin e objektit të kësaj marrëveshjeje, palët angazhohen në realizimin e aktiviteteve të mëposhtme:

- a) Përgatitjen e materialeve informuese dhe promovuese;
- b) Zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta si: info-days, seminare, tryeza të rrumbullakta, trajnime të ndryshme që kanë për qëllim ndërgjegjësimin e start up-ve, SME-ve dhe korporatave për rëndësinë e pronësisë industriale:

- c) Vendosjen e materialeve promovuese në mjediset e INNVEST në lidhje me informimin e bizneseve, nëpërmjet fletë-palosjeve për pronësinë industriale;
- d) Çështje të tjera me interes të përbashkët.

Neni 3

Detyrimet e Palëve

Në realizimin e aktiviteteve të parashikuara në këtë marrëveshje:

- a) DPPI merr përsipër të vërë në dispozicion të INNVEST: materialet informuese, specialistët dhe ekspertët që do të ofrojnë seminare apo trajnime për biznesin në fushën e pronësisë industriale: bazën e nevojshme materiale për INNVEST;
- b) DPPI merr përsipër që të kryejë trajnime për personelin e INNVEST, në fushën e pronësisë industriale.
- c) INNVEST merr përsipër organizimin e logjistikave dhe pjesëmarrjen në rekrutimin e pjesëmarrësve në këtë seri trajnimesh.

Neni 4

Hyrja në fuqi, ndryshimi dhe përfundimi

- a) Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga palët dhe është e vlefshme deri sa palët të kërkojnë me shkrim shfuqizimin ose përfundimin e saj.
- b) Asnjë ndryshim nuk mund t'i bëhet marrëveshjes në mënyrë të njëanshme, përveçse me shkrim, si dhe pasi palët kanë rënë dakord paraprakisht ndërmjet tyre dhe të kenë autorizuar ndryshimin, nëpërmjet nënshkrimit nga titullarët e palëve.
- c) Shfuqizimi në mënyrë të njëanshme mund të bëhet në çdo kohë nga secila prej palëve, duke lajmëruar me shkrim tridhjetë (30) ditë më parë, palën tjetër.

Neni 5

Monitorimi i zbatimit

- a) Me qëllim vlerësimin e suksesit në përmbushjen e objektit dhe qëllimit të kësaj marrëveshje. DPPI merr përsipër të përgatisë një raport vlerësues çdo 6 muaj nga data e hyrjes në fuqi e marrëveshjes.
- b) Raporti vlerësues do t'i paraqitet për miratim palës tjetër, pasi ky raport të jetë diskutuar më parë në takimin e përbashkët mes përfaqësuesve të të dyja palëve, që mbledhet për këtë qëllim.

Neni 6

Dispozita finale



- a) Marrëveshja hartohet dhe pranohet nga palët, duke nënkuptuar se asnjë pjesë e saj nuk është në tejkalim ose kundërshtim të dispozitave përkatëse ligjore, mbi të cilat palët mbështesin ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre.
- b) Palët zotohen të zbatojnë vullnetarisht dhe në kushte mirëbesimi këtë marrëveshje, për sa parashikohet në të. Mosmarrëveshjet zgjidhen nëpërmjet mirëkuptimit reciprok. Në rast të kundërt, secila nga palët mund të tërhiqet dhe të ndërpresë në mënyrë të njëanshme marrëveshjen.
- c) Pikat e kontaktit për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje, do të jenë:
 - Znj. Sonila Meka Përgjegjës Sektori nr. kontakti: +355673571802, e-mail sonila.meka@dppm.gov.al, si përfaqësuese e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.
 - Znj. Alda Lale, Drejtor, nr. kontakti +355676020058, e-mail: aldalale@innvestfund.com, si përfaqësuese e Innovation Investment Fund.

Marrëveshja hartohet në 3(tre) kopje identike dhe nënshkruhet nga palët.

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E PRONËSISË INDUSTRIALE**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

LEDINA BEQIRAJ



**INNOVATION INVESTMENT
FUND**

THEMELUESE DHE DREJTORE

FABIOLA DURO

